



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

IDA. Berat MARMULLAKU <i>Ekspert Shqyrtues Profesional / Teknik</i>	Data e autorizimit të ekspertit <i>09.06.2022</i>	Data e dorëzimit të raportit <i>14.06.2022</i>
---	---	--

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.06.2022, operatori ekonomik **MATKOS Pharm SH.P.K.** nga Prishtina, kanë parashtruar ne OSHP ankesën me nr. **183/22** kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për aktivitetin e prokurimit: **“ Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU ”** me nr. të prokurimit: **616-22-2096-1-1-1** dhe nr. te brendshëm: **616-22-021-111**, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: **E hapur**

Lloji i kontratës: **Furnizim**

Vlera e parashikuar e kontratës: **480,000.00 €**

Kriteri për dhënie te kontratës: **Çmimi më te ulët i poentuar**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

- Njoftimi për kontratë, dt. 17.03.2022
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së, dt. 18.05.2022
- Kërkesë për Rishqyrtim, dt. 23.05.2022
- Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, dt. 24.05.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Rregullat e Tenderëve Jo-Normalisht te Ulet, Neni 3

Neni 61 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Vendimi i OSHP-së PSH.NR.158-164/21

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 18.05.2022, për këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë 5 operator ekonomik, kurse me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve kanë rezultuar 4 tender të përgjegjshëm. Mirëpo pas analizimit të

Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 18.05.2022 kemi vërejtur se tenderi i OE "Madekos" të rekomanduar për kontratë është dashur të kategorizohet si tender jo normalisht i ulët për shkak se përmbushen tri (3) kushtet themelore të përcaktuara në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Sipas këtij rregulli, **kushti i parë** është që çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm. Pra, për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 4 OE me çmime të ofertave si në vijim:

1. 37.87 euro
2. 67.53 euro
3. 118.47 euro
4. 248.28 euro

Shuma e mbledhur e të katër tenderëve është 472.15 euro. Kur pjesëtohet shuma 472.15 euro me numrin e tenderëve të përgjegjshëm (4 tender të përgjegjshëm sipas AK-së), rezulton që çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm është 118.03 euro, si dhe kur çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm 118.03 euro pjesëtohet me 1.3 sipas formulës, rezulton shuma prej **90.79 euro** apo pragu minimal për tu trajtuar si tender jo normalisht i ulët. Kurse, OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej **37.87 euro** apo 2.5 herë më pak se pragu prej **90.79 euro**. Pra kushti i parë është plotësuar që të trajtohet si tender jo normalisht i ulët.

Edhe pse duhet cekur se te ky kusht, në fakt janë vetëm 3 tender të përgjegjshëm sepse grupi i OE "Solution" ka ndërhyrë në paramasë, ku më poshtë do të jepen arsyet pse ky OE është i pa përgjegjshëm.

Kushti i dytë sipas rregullit është që çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët. OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 37.87 euro, kurse tenderi i dytë me çmim është 67.53 euro. Rrjedhimisht rezulton se tenderi i OE të rekomanduar është pothuajse 100% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët. Edhe kushti i dytë është plotësuar që të trajtohet si tender jo normalisht i ulët.

Kushti i tretë sipas këtij rregulli është që të jenë të dorëzuar të paktën 3 (tre) tender, kurse për këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tender të përgjegjshëm. Edhe ky kusht është plotësuar që tenderi i OE të rekomanduar të kategorizohet si tender jo normalisht i ulët.

Duke i pasuar parasysh se tri kushtet themelore janë plotësuar që OE i rekomanduar ka dorëzuar tender jo normalisht të ulët, me datë 18.05.2022 kemi kërkuar qasje në ofertën financiare të OE të rekomanduar dhe pasi na është lejuar qasja, kemi analizuar ofertën financiare të OE të rekomanduar dhe kemi vërejtur çmime jo normalisht të ulëta në shumë pozicione, kurse në pozicione të caktuara kemi vërejtur çmime ekstrimisht të larta. P.sh. për dorëza kirurgjike te pozicioni 31 i paramasës "Gloves surgical steriles pair 6.5 1x50 palë", OE i rekomanduar ka ofertuar me çmim prej 1.10 euro, kurse çmimi furnizues me kostot e transportit (landing cost) është 8 euro. Ngjashëm OE i rekomanduar ka ofertuar për dorëza kirurgjike te pozicioni 32, 33, 34, 35 me çmime prej 1.20 euro dhe 1.30 euro, kurse çmimet furnizuese janë 7 herë më të larta.

Kurse të disa produkte tjera, OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime shumë më të larta se çmimet e tregut, sikurse të pozicioni 127, 128, 129, 130, 131, ku te këto pozicione është ofertuar me çmime 3-4 herë me çmime më të shtrenjta se ofertat e OE tjerë. Pra këto ndryshime kaq të mëdha në çmime, varësisht pozicionit, neve na lënë të paragjykojmë se njësia kërkuese nuk do ti porositë asnjëherë apo fare pak pozicionet në të cilat është ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe do të porosit pozicionet me çmime ekstremisht të larta. Këtë e përforcon edhe më

shumë kur analizohet pozicioni 128 (alkool) me çmim 4 euro, kurse çmimi i tregut është nga 1.7 euro deri 1.9 euro, pastaj pozicioni 129 (hidrogjen) ku çmimet e tregut janë nga 60 cent deri 80 cent, kurse OE i rekomanduar ka ofertuar me 4 euro. Pra, në njërin anë ka shumë pozicione të tilla që gjatë zbatimit të kontratës AK do të pësoj dëme në vlerë të konsiderueshme financiare dhe në anën tjetër ndikon në eliminim të konkurrencës.

Përveç kësaj, KRPP ka lëshuar interpretim të pyetja me numër rendor 85, ku ka cekur se AK duhet ti ekzaminoj me kujdes të shtuar çmimet për njësi.... më poshtë është bashkangjitur interpretimi i KRPP-së:

85. 08.06.2021 A zbatohet neni 61 i LPP-së dhe "Rregullat për çmime jo-normalisht të ulëta" edhe në rastin e kontratave "me çmime njësi" sipas nenit 56.15 të RRUOPP, si dhe a mund të kërkohej sqarime nga OE edhe për pozicione jo-normalisht të ulëta?

Konform neni 87, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe të Legjislacionit dytësor si në vijim:

Kurdo që AK ka për qëllim të lidhë një "kontratë me çmime njësi", në përputhje me nenin 56.15 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave, ndërsa "Kontrata lidhet me çmime për njësi", prandaj autoriteti kontraktues duhet ti ekzaminojë me kujdes të shtuar çmimet për njësi dhe në rast se dyshon se tenderuesi ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta në një apo më shumë artikuj/pozicione, duhet të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 4 të Rregullave për çmime jo-normalisht të ulëta, i cili përcakton procedurat e shqyrtimit inter partes si në vijim:

- 4.2. Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ulët, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zërtim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".
- 4.3. Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.
- 4.4. Pasi që Autoriteti Kontraktues merr shpjegim me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet:
 - o 4.6.1. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose
 - o 4.6.2. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-së të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit.

Për më tepër, pragu minimal që një tender të trajtohet si jo normalisht i ulët rritet edhe më shuma për shkak se mbesin vetëm 3 tender të përgjegjshëm për arsyet që do të jepen në vijim. Përveç asaj që u cek më lartë, komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka pasur parasysh edhe ndërhyrjen në paramasë nga grupi i OE "Solution D SH.P.K.; MEDPLUS SH.P.K.; Ekrem Rexha Nr.28-Prishtinë". Ky grup i OE ekonomik ka shtuar 3 pozicione në paramasë me 3 produkte, më saktë pozicionin numër 71, 72 dhe 73 i ka shtuar në paramasë dhe kjo ndërhyrje në paramasë e bënë të pa përgjegjshëm ashtu siç është përcaktuar në nenin 59.4:

- Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimet e sipër cekura janë parashtruar në kërkesën për ri shqyrtim pran AK-së me datë 23.05.2022, kurse AK nxjerr vendim duke e refuzuar kërkesën për ri shqyrtim me arsyetimin se praktika gjyqësore e OSHP-së në shumë vendime e sidomos në vendimin nr.590/19 thekson qartazi se tek çmimi më i ulët i poentuar nuk mund të bëjmë krahasime çmimet e njërit ofertues me çmimet e ofertuesit tjetër pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuar të bazohen në çmimin e ofertuar dhe jo duke i krahasuar me çmimet e ofertuesve tjerë. Për këtë konstatim të

AK-së, ne konsiderojmë se ekziston një praktikë gjyqësore e re nga OSHP dhe AK është dashur ta merr parasysh edhe praktikën e re gjyqësore në mënyrë që të vendos drejtë dhe të mos lidh kontratë të dëmshme. Për shembull vendimi i OSHP-së PSH.NR.158-164/21, fq. 7, e precizon saktësisht situatën e njëjtë sikurse të ky aktivitet i prokurimit. Sipas këtij vendimi, AK kishte aplikuar procedurën e peshimit të çmimeve. Kurse, OSHP në këtë vendim i kishte aprovuar si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik dhe kishte konstatuar se është duke u keqpërdor nga operatorët ekonomik duke ofertuar me çmime shumë të ulëta dhe e saktëson pozicionin përkatës, ku në fund Paneli Shqyrtues vendos dhe konstaton se pozicioni përkatës është me çmim manipulues. Më poshtë është shkëputur një pjesë e vendimit PSH.NR.158-164/21:

Lidhur me pretendimin e të dy operatorëve ekonomik ankues se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dhënë çmime jo normalisht të ulëta dhe manipulative, Paneli shqyrtues sqaron se, tani e një kohe nuk jemi marrë me çmime kur autoriteti kontraktues vendos çmimet me poentim por kjo po keqpërdoret nga Operatorët ku kemi rastin konkret që OE i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime shumë të ulëta në pozicionin ku nëse e marrim vetëm pozicionin C.9 ka vendosur çmim prej 0.1 Euro, si më poshtë të përshkruar nga ankuesi sipas ankesës 164/21:

C.9	Furnizimi me material dhe punimi i kokave hyrëse dhe dalëse nga Betoni duke përfshirë kallupimin, montimin e armaturës së nevojshme dhe Betonimi,	M3	0.10 euro	Ky pozicion është tejet i rëndësishëm për parandalimin e përmbytjeve të rrugëve, tokave bujqësore etj. Pra ky pozicion ka rol crucial në parandalimin e fatkeqësive natyrore e që është edhe vetë qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit. Nuk ka asnjë mundësi që OE ta arsyetojë këtë çmim skandaloz sepse vetëm furnizimi me Beton për 1m3 ka kosto prej 50euro dhe kur shtohet kallupimi, montimi i armaturës dhe betonimi ky pozicion nuk ka mundësi të realizohet me 10cent. Çmimi mesatar për këtë pozicion është mbi 70.00euro për 1m3.
-----	---	----	-----------	--

Pra siç shihet më lartë nëse e marrim vetëm këtë pozicion shihet qartë se është çmim manipulues dhe kurrësi asnjë Operator ekonomik me këtë çmim nuk e realizon këtë pozicion, Paneli shqyrtues konstaton se këto pretendime të operatorëve ankues janë të bazuara.

Faqe 7 nga 8

Përveç këtij vendimi që AK nuk e ka marr parasysh fare, ka injoruar në tërësi interpretimin e KRPP-së të pyetja 85 ashtu siç është cekur në kërkesën për ri shqyrtim. Përkundrazi, AK merr rolin dhe kompetencën e KRPP-së duke bërë përpjekje të interpretoj normat ligjore sipas dëshirës, ku në vendim cek se:

"procedura e çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoritetet kontraktuese nuk e di sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë 1. Gjatë zbatimit të kontratës porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për të vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi. Për këta tenderë nuk mund të aplikohet formula për përllogaritjen e çmimit jo normalisht të ulët, pasi çmimi është i poentuar".

Megjithatë, konstatimi i cekur më lartë nga AK, na len të kuptojmë se AK nuk e analizon fare interpretimin e KRPP-së tek pyetja 85, ku KRPP ka dhënë udhëzime të qarta. KRPP në këtë interpretim thotë që kurdo që AK ka për qëllim të lidhë një **"kontratë me çmime njësi"**, në përputhje me nenin 56.15 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave, ndërsa **"Kontrata lidhet me çmime për njësi"**, prandaj autoriteti kontraktues duhet t'i ekzaminojë me kujdes të shtuar **çmimet për njësi** dhe në rast se dyshon se tenderuesi ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta në një apo më shumë artikuj/pozicione, duhet të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 4 të Rregullave për çmime jo-normalisht të ulëta, i cili përcakton procedurat e shqyrtimit *inter partes*.

KRPP potencon në këtë interpretim se kur AK ka për qëllim të lidhë një kontratë me çmime për njësi në përputhje me nenin 56.15 të RRUOPP-së, atëherë është i pashmangshëm dhe nuk guxon AK që të injoroj nenin 56.15. Për më tepër, neni 56.15 flet për çmimet e peshuara dhe ky nen sqaron se në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Pra e gjithë baza e interpretimit të KRPP-së tek pyetja numër 85 flet për çmim të poentuar (peshuar).

Pika 56.15 e RRUOPP-së:

Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse ndërsa për qëllime të raportimit në KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (vetëm për riparime dhe mirëmbajtje).

Na pëlqej apo nuk na pëlqej neve si operator ekonomik, i pëlqen apo nuk i pëlqen autoritetit kontraktues, ne jemi të detyruar që të ndjekim dhe zbatojmë rregullat e përcaktuara nga KRPP sepse është organ rregullativ. Andaj, AK me rastin e refuzimit të kërkesës për ri shqyrtim vepron në kundërshtim me interpretimet e KRPP-së dhe nuk cek asnjë bazë ligjore në vendim.

Përveç kësaj, vet AK bien në kundërshtim me vetveten sepse thotë që nuk e din sasinë e artikujve që do të porosisë, kurse në anën tjetër lejon hapësirë manipulimi gjatë zbatimit të

kontratës që të porositen artikuj me çmime ekstremisht të larta kurse artikujt me çmime jo normalisht të ulëta (manipulative) të mos porositen asnjëherë. Këto shkelje qojnë edhe në shkelje të LPP-së, konkretisht nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse në rast se i jepet kontrata operatorit ekonomik me çmime të tilla, atëherë autoriteti kontraktues do të paguaj artikuj të caktuar me çmime shumë herë më të larta se ofertat tjera dhe nuk do të porosit artikujt me çmime manipulative.

Andaj, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të kërkesës tonë të zbatoni drejtë dispozitat e përcaktuara në ligj, konkretisht të zbatoni drejt interpretimin e KRPP-së sipas pyetjes numër 85, duke aprovuar ankesën tonë, të detyroni AK që të bëjë rivlerësimin e ofertave në bazë të nenit 59 të LPP-së dhe Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- Vendimi i OSHP-se Nr. 590/19 i datës 13.11.2019
- Vendimi i OSHP-se Nr. 947-953/20 i datës 22.12.2020
- Vendime tjera të OSHP-se, të ngjashme me dy të lartcekurit

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje në Pretendimet ankimore, neni 113 i LPP-së.

Ne lidhje me pretendimin ankimor të ankesës se AK është dashur që OE e rekomanduar ta eliminojë si Tender Jo-Normalisht i Ulët, ekspertit shqyrtues këtë pretendim e konsideron i të pa bazuar dhe i takon AK trajtimi i çmimeve si Jo-Normalisht të Ulëta dhe përdorimi ose jo i rregullores B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 61 të LPP-së, ku është e specifikuar se: " Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që është **ose duket të jetë jo-normalisht i ulët**,..." – është dhënë alternative " **është ose duket** " që AK ta vlerësojë dhe vendosi për një gjë të tillë, bazuar edhe në opinionin e KRPP-së tek pyetjet e shpeshta Nr. **71. 13.02.2020**. ku specifikohet se: **Sipas nenit 59 të LPP-së, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.**

Sa i përket Vendimit për Rishqyrtim të Kërkesës për Rishqyrtim nga ana e AK dhe arsyeshmerinë që ka dhënë AK kur i është referuar vendimit të OSHP-se Nr. 590/19, ekspertit shqyrtues pajtohet me këtë vendim të rishqyrtimit të AK, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe vendimet e shumta nga PSH i OSHP-se për raste të ngjashme.

Përveç vendimit të OSHP-se Nr. 590/19 të caktuar nga AK gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ekzistojnë edhe shumë vendime të ngjashme nga ana e OSHP-se me konstatime të ngjashme, ku mund ta veçojmë Vendimin e PSH me Nr. 947-953/20 të dt. 22.12.2020, në të cilin ndër të tjera specifikohet se Rregullorja për tenderët Jo-normalisht të ulët gjen zbatim të kriterit "Çmimi me i ulët" por jo edhe të kriterit çmimi me i ulët i poentuar, shih paragrafin si më poshtë:

Paneli Shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit lidhur me nenin 61 të LPP-së dhe “Rregullorja për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57)”, për këtë pikë pretenduese kemi vendime të OSHP-së të cilët ndër të tjera sqarojnë se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohen praktikatat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rast kur kemi krahasimin e çmimeve me ofertat të ndryshme me njëra –tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjen zbatim rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët. Apo, kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga pikët maksimale përcaktohet fituesi, pra te kriteri tenderi me çmim më të lirë të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Në këtë kuptim sqarohet se Rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët gjen zbatim te kriteri “Çmimi më i ulët” por jo edhe te kriteri çmimi më i ulët i poentuar.

Gjithashtu PSH në këtë vendim (Nr. 947-953/20 të dt. 22.12.2020) ka potencuar se me rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar – minimizohet mundësia e manipulimit me çmime:

Paneli shqyrtues sqaron se në rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, P.sh nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-ës. kjo në baze të interpretimit të KRPP-se të datës 10.12.2019 tek Pyetjet e shpeshta, pyetja nr.62.

Sipas shumë Vendimeve të OSHP-se për raste të ngjashme specifikohet se: **“ kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohen praktikatat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjerë “.**

Në baze të dokumentacionit të lëndës, shifet se AK i ka respektuar dispozitat e parapara sipas nenin 56.15 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku specifikohet se: **“ 56.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dëgjon sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.”**

AK tek Përshkimi i Çmimeve si pjese e Dosjes se Tenderit, Listën e produkteve e ka ndarë ne mënyrë te qartë ne tri kategori dhe me përqindje (%) te peshimit për secilën prej tyre:

Kategoria 1 – (artikujt nga 1 deri 58) – 50%

Kategoria 2 – (artikujt nga 59 deri 126) – 30%

Kategoria 3 – (artikujt nga 127 deri 181) – 20%

I - Gjithsej (1-58):50%	€ 0.00	€ 0.00
II - Gjithsejt (59-126) :30%	€ 0.00	€ 0.00
III - Gjithsejt (127-181) :20%	€ 0.00	€ 0.00
Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj vlere). Kjo është vlere e cila do te duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.		

Ndarja e artikujve ne Përqindje (%) ne tri kategori (50%, 30% dhe 20%), behet ne mënyrë proporcionale me nevojat e autoritetit kontraktues dhe kjo përqindje duhet te përcillet gjate implementimit te kontratës, ku realizimi i pozicioneve duhet te behet ne përputhje me përqindjet e përcaktuara.

Referimi ne vendimet paraprake te OSHP-se për situata te ngjashme, gjene zbatim duke marre parasysh se ekziston një Memorandum Mirëkuptimi ne mes OSHP-se dhe KRPP-se me Nr. 679/20 i datës 14.10.2020.

Sa i përket pretendimit ne lidhje me ofertën e grupit te OE “Solution D & MEDPLUS “ ku pretendon se ky grup i OE i ka shtuar 3 pozicione ne paramasë, konkretisht pozicionet Nr. 71, 72 dhe 73, konsideroj se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, duke marre parasysh se ne Përshkrimin e Çmimeve si pjese e DT ne formatin excel, pozicionet Nr. 71, 72 dhe 73, kishin qene si rreshta te mbyllur “te fshehur” andaj nuk mund te dëmtohen ofertuesit për një çështje teknike ose lëshim teknik nga ana e AK.

Oferta grupit te OE “Solution D & MEDPLUS “ është rreth 100% me e larte se oferta e rekomanduar për kontrate dhe njëherit është pajtuar me Njoftimin mbi Vendimin e AK, duke mos u ankuar ne këtë vendim qe rrjedhimisht nuk është pale e interesuar me tutje ne këtë aktivitet.

Gjithashtu AK ka marre ne konsideratë edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe oferta e oe ankues është mbi 200% me e larte se oferta e oe te rekomanduar për kontrate, kur dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosovë.

OE i rekomanduar ka ofruar sqarime shitesë për OSHP-ne, duke sqaruar ne mënyrë tekstuale dhe me dëshmi nga prodhuesi arsyeshmerine financiare për çmimet e ofruara ne ofertë, dëshmitë si ne vijim:

Për : OSHP-në
Cc: Komuna e Prishtinës
Ankesa nr.: 183-22
Nr.i prokurimit : 616-22-2096-111
Nr.i brendshëm: 616-22-021-111
Titulli: Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU
Data : 08.06.2022

NJOFTIM
për ankesën nr.183/22

Kompania MADEKOS sh.p.k. (811560293) si palë e procesit (OE i rekomanduar për kontratë), lidhur me tenderin e lartëpërmendur, ju njoftojmë OSHP-në se nuk qëndrojnë pretendimet e OE ankues për cmimet jo-normalisht të ulëta, për arsyet e mëposhtme:

OE ankues ka bërë ankesë të rrejshme duke pretenduar se cmimet furnizuese janë 8 Euro ku në me produktin dorëza kemi bashkëpunim me furnizues nga Kina, Malajzia dhe India më shumë se 10 vite, pasi që për produktin dorëza jemi ndër furnizuesit me serioz në tregun tonë. Cmimi i furnizimit për dorëzat e ofruara të kompanisë sonë edhe pse janë sekret afarist ne jemi të detyruar për të marrë një vendim të drejtë tua bashkangjesim në këtë Njoftim:

Gloves surgical steriles 6.5 – 0.021\$- dollar, ku një pako me 50 palë është 1.05 \$ Dollar.

Gloves surgical steriles 7.0 – 0.024\$- dollar, ku një pako me 50 palë është 1.20 \$ Dollar.

Gloves surgical steriles 7.5 – 0.024\$- dollar, ku një pako me 50 palë është 1.20 \$ Dollar.

Gloves surgical steriles 8.0 – 0.024\$- dollar, ku një pako me 50 palë është 1.20 \$ Dollar.

Gloves surgical steriles 8.5 – 0.024\$- dollar, ku një pako me 50 palë është 1.20 \$ Dollar.

Kur të bëhet përlogaritja në shumëzim të dollarit me euro, bëhet shtesa e transportit dhe tvsh-së atëherë marzha jonë për këto produkte del afro 10-15%.

Lusim autoritetin tuaj të marrë vendim të drejtë dhe meritore pasi që kjo ankesë ka ardhur nga një Operator Ekonomik që renditet i 4-ti për nga cmimi (nuk është palë e dëshmuar me interes) dhe është vetëm e vetëm për bllokimin e institucionit me furnizim me barna dhe dëmtimin tonë si Operator Ekonomik.

Si deshmi me këtë njoftim gjeni:

- Deklaratë e dorëzuar nga ne si Operator ekonomik në ofertën e datës 28.04.2022 se garantojmë se cmimet janë të tregut dhe reale,
- Ofertën e vulosur dhe nënshkruar nga prodhuesi.

Pra, në fund ju konfirmojmë se ne qëndrojmë prapa ofertës sonë dhe furnizimi do të bëhet në bazë të kërkesave të Autoritetit Kontraktues në përpikëri të plotë, ku jemi të gatshëm për sigurinë e Autoritetit kontraktues të bëjmë sigurimin e ekzekutimit nga 10% në 20% të vlerës së kontratës.

Me respekt,
MADEKOS sh.p.k.



Për : Kuvendi i Komunës së Prishtinës
Nr.i prokurimit : 616-22-2096-111
Nr.i brendshëm: 616-22-021-111
Titulli: Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU
Data : 28.04.2022

DEKLARATË

për specifikacionet teknike për shërbimet e ofruara të cilat përputhen me ato të
përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit

Kompania Made-Kos me seli në Prishtinë deklaron se specifikacionet teknike për mallrat e ofruara në ofertë përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit – Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU dhe me nr. të prokurimit : 616-22-2096-111.

Produktet e ofruara në ofertën tonë janë të çertifikuara me ISO 9001&13485 , CE Europiane dhe te Regjistruara ne EU etj .

Afati i skadencës sipas kushtëve të kontratës.

Produktet farmaceutike do të dorëzohen me banderola të Republikës së Kosovës.

Çmimet janë të tregut, reale dhe produktet të kualitetit të lartë.

Me respekt,
28.04.2022





HANGZHOU DEMO MEDICAL TECHNOLOGY CO., LTD.

Add: 303, Building No.6 Zhongee Garden No.8 Str, Hangzhou Eco And Tec Area, Zhejiang, China
Tel: (86)571 87390575 Website: www.demomedical.com Email: info@demomedical.com

QUOTATION

TO: MADEKOS SH.P.K Vragoli , Fushe Kosove, Kosove TEL: +38344506414						No.DM22405212		
						Date: 2022.04.20		
Descriptions and Quantities						Unit Price	Amount	
No.	Size & Packing	Qty.	Unit	CTNS	Vol./ CTN	FOB Shanghai	Total Vol.	TOTAL FOB AMOUNT
1	Gloves Surgical steriles 6.5#, 1pair/pack,50pairs/box, 10box/ctn. 67X25X40		Pair		0.067	US\$0.0210		
2	Gloves Surgical steriles 7.0#, 1pair/pack,50pairs/box, 10box/ctn. 67X25X40		Pair		0.067	US\$0.0240		
3	Gloves Surgical steriles 7.5#, 1pair/pack,50pairs/box, 10box/ctn. 67X25X40		Pair		0.067	US\$0.0240		
4	Gloves Surgical steriles 8.0#, 1pair/pack,50pairs/box, 10box/ctn. 67X25X40		Pair		0.067	US\$0.0240		
5	Gloves Surgical steriles 8.5#, 1pair/pack,50pairs/box, 10box/ctn. 67X25X40		Pair		0.067	US\$0.0240		
				Total				

Payment Term: 30% TT in advance, 70% balance paid against copy of B/L

Delivery Time: Within 45days on receipt of the deposit

The Seller:

HANGZHOU DEMO MEDICAL TECHNOLOGY CO.,LTD.

Sign & Stamp



The Buyer

MADEKOS N.SH.T

Sign & Stamp

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik MATKOS Pharm SH.P.K. të refuzohen si e pa bazuar, rrjedhimisht të mbetet ne fuqi Vendimi i AK për Dhënie të Kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNËS SE PRISHTINËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **MATKOS Pharm SH.P.K.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **MATKOS Pharm SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit “ **Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU** ” me nr. të prokurimit: 616-22-2096-1-1-1 dhe nr. te brendshëm: 616-22-021-111, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**